



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 33
Prishtinë, më 5 tetor 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Elmi Reçica, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Puhie Demaku.

Në këtë takim, po ashtu morën pjesë edhe deputetët e Kuvendit, Donika Kadaj Bujupi dhe Albulena Haxhiu.

Pjesëmarrës nga MPJ: Enver Hoxhaj, ministër i MPJ-së, Lulzim Mjeku, Albert Prenkaj, Bashmir Xhemaj, Fitim Gllareva dhe Albinot Bimbashi, MPJ.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Eugen Cakolli, KDI; Blerta Bejtullahu, EUSR; Gurjeta Zeka, LVV; Taulant Salihu, KREK; Lumnije Murati, ZPRK; Dren Ajeti, GSJP; Vlora Nushi, UNMIK/OPA dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj.

Elmi Reçica, falënderoi ministrin Hoxhaj për gatishmërinë, që t'i përgjigjet ftesës së Komisionit, për të raportuar lidhur me aktivitetet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, prioritetet e politikës së jashtme, si dhe për tema të tjera, të cilat janë në interes të deputetëve.

Enver Hoxhaj, theksoi se me kënaqësi ka pranuar ftesën për të raportuar në Komision, ku do të informojë për zhvillimet kryesore, në vija të përgjithshme, për atë që është bërë deri më tani në

MPJ. Politikën e jashtme e kuptojmë si një proces i cili ndodh në dy nivele, si realizim të interesit të vendit, të përcaktuar brenda vendit dhe zbatim i saj jashtë vendit, tha z. Hoxhaj.

Që nga emërimi i ri në detyrën e ministrit, bëri të ditur se ka pasur koordinim të ngushtë me çdo institucion në vend, në baza ditore dhe kontinuitet të bashkëpunimit. Informoi anëtarët e Komisionit se nga java e kaluar janë marrë në mënyrë intensive, me rastin e z. Nehat Thaçit, oficerit të lartë të policisë dhe janë angazhuar dhe do të angazhohen që z. Thaçi të lirohet sa më shpejt, duke cekur se këto akte, nga ana e Serbisë, janë të papranueshme. Kemi formuar një grup të punës, i cili në mënyrë intensive është duke bërë përpjekje që ta mbështesë z. Thaçin. Në këto dy tri javët e fundit ka një agjendë provokuese të Serbisë në rajon, nga ajo se çfarë ndodhi në Republikën Serbska, ku prapa referendumit qëndron Serbia, e deri tek interferimi në punë të brendshme të Kosovës, interferimi zgjedhor në Mal të Zi, por edhe në vendet e tjera të rajonit. Njoftoi se për shkak të sjelljeve provokuese dhe deklaratave të tij kundër shtetit të Kosovës, nuk është lejuar që të hyjë në Kosovë, z. Marko Gjuriq, këto dy javët e fundit. Z. Hoxhaj njoftoi se prioritet parësor gjatë këtyre muajve të fundit ishte agjenda evropiane, ku edhe Kuvendi i Kosovës duhet të ketë një rol më të madh, lidhur me zbatimin e MSA-së, e më pas të presim për qasje në marrëveshjet kornizë të programeve të BE-së. Planifikojmë që gjatë vitit 2016 dhe 2017, të zbatojmë agjendën evropiane të reformave, dhe në fund të vitit 2017, të aplikojmë për pozitën e vendit, kandidat të BE-së, meqë në agjendën evropiane jemi të fundit në lëvizje, në krahasim me vendet e rajonit, tha z. Hoxhaj. Lidhur me liberalizimin e vizave, tha se kemi pasur një situatë të vështirë gjatë muajit shtator dhe se është mirë që në ardhmen të kemi një koordinim më të ngushtë me Kuvendin e Kosovës dhe të koncentrohemi në mbështetjen e shteteve nacionale, të punojmë me institucionet e BE-së dhe të ratifikojmë marrëveshjen për demarkacionin e kufirit mes Kosovës e Malit të Zi. Bëri të ditur se nga vera e këtij viti, nga konkluzat e Samitit të Varshavës, për herë të parë ka filluar të ndërtohet një partneritet i ri, që duhet ta ketë shteti i Kosovës me NATO-n. Më tej, theksoi se fokus tjetër i MPJ-së, ka qenë njohja ndërkombëtare e Kosovës, sepse po ta kishim njohjen e 2/3 të anëtarëve të OKB-së, do të ishim të gatshëm të anëtarësoheshim në shumë organizata ndërkombëtare. Lidhur me anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare e institucione multilaterale, njoftoi se kjo çështje përcillet me një analizë se cilat janë përfitimet tona nga këto anëtarësime. Gjatë kësaj periudhe njoftoi se është arritur që Kosova të anëtarësohet në Gjykatën e Arbitrazhit, Konventën e Apostiles dhe në Byronë Ndërkombëtare të Ekspozitave, ndërsa prioritet mbetet aplikimi në INTERPOL, në UNESCO dhe anëtarësimi në Këshillin e Evropës. Lidhur me diplomacinë ekonomike, për të cilën tha se deri më tani nuk ka qenë prioritet, ka një rritje të investimeve të huaja në Kosovë. Duke u ndërlidhur me raportet me vendet e rajonit, theksoi se sa i përket Shqipërisë, pos bashkëpunimit në fusha të tjera, kemi hapur një konsullatë të përbashkët në Bari të Italisë, do të hapet së shpejti edhe në Munih, do të duhej të kemi konsullatë të përbashkët në Stamboll, si dhe planifikohet një konsullatë e përbashkët në Danimarkë. Lidhur me bashkëpunimin rajonal, tha se kemi bashkëpunim të ngushtë politik e ekonomik me vendet e tjera të rajonit, por aktivitetet e ndikimit rus, në çdo shtet tjetër të rajonit, mund të ketë pasoja edhe për Kosovën.

Ismet Beqiri, çmoi punën e ministrit Hoxhaj, bazuar në elaborimin dhe aktivitetet e përmbushura gjatë këtyre 3-4 muajve të punës së tij, në detyrën e ministrit. Përkrahu ministrin Hoxhaj për dinamizmin e aktiviteteve të diplomacisë parlamentare, për të cilat tha se për shtetin tonë është i nevojshëm bashkëpunimi i Qeverisë me Kuvendin, në takime të rëndësishme të veçantë. Theksoi se për Komisionin është e nevojshme që të ketë raportime të këtylla më të shpeshta periodike, që të njoftohen dhe të kenë informata, lidhur me aktivitetet e MPJ-së.

Zafir Berisha, njoftoi se ka kërkuar që ministri i Jashtëm të raportojë në Komision, pasi që gjatë tërë kësaj legjislature, nuk ka pasur asnjë raportim të ministrit të Jashtëm në Komision, edhe pse ish- ministri i Jashtëm, tani president, nuk i është përgjigjur tri ftesave të Komisionit, për të raportuar para deputetëve. Duke u ndërlidhur me raportimin e ministrit Hoxhaj mbi aktivitet e ministrisë, pyeti ministrin se a është mjaftueshme kjo që është bërë. Dështimi për anëtarësim në disa mekanizma ndërkombëtarë, e vë në pikëpyetje punën e nevojshme, që duhet ta bëjë ministria, në raport me prezantimin dhe integritetin e shtetit të ri të Kosovës në strukturat ndërkombëtare. Më tutje, tha se anëtarëve të Komisionit u është shpërndarë një shkresë nga 32 zyrtarë të MPJ-së, për shumë parregullsi dhe shumë shkelje ligjore, si dhe padrejtësi që po u bëhen punëtorëve.

Në këtë shkresë, paraqitet një renditje e problemeve që i përcjellin punëtorët e MPJ-së dhe mos-ndërhyrja për rregullimin e këtyre çështjeve, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e brendshme, ka sjellë përplasje fizike në MPJ, që është edhe më shqetësuese. Është detyrë e ministrit dhe stafit përgjegjës që të angazhohen, që këto parregullsi të mos përsëriten, ngase bartin imazhe jo të mira për shtetin tonë, tek miqtë ndërkombëtarë. Lëvizja dhe transferimi i punëtorëve nga ministritë e tjera në MPJ, ka nënvlerësuar ata që punojnë qysh nga themelimi i MPJ-së, të emëruar këshilltarë politikë, e pastaj kalimi prej këshilltarëve, në mision diplomatik e konsullor, jashtëligjshëm, kthimi nga konsullatat e ambasadat në MPJ, dërgimi i njerëzve pa përvojë në trupin diplomatik, janë disa nga shqetësimet për të cilat MPJ, pos që duhet ta njoftojë Komisionin, njëkohësisht, duhet të marrë masa që këto dukuri të mos përsëriten, tha z. Berisha. Lidhur me avancimin në diplomacinë ekonomike, tha se nuk është duke i vërejtur efektet e saj, ndërsa sa u përket njohjeve ndërkombëtare, tha se është ihtar që njohjet, pasi të ndodhin, të lajmërohen, sepse shpesh njohjet e paralajmëruara, nuk kanë ndodhur. Z. Berisha, tha se problemet të cilat e kanë përcjellë MPJ-në, kohët e fundit, nuk duhet ta përcjellin më, ngase kemi obligim ligjor, moral e kombëtar të punojmë për shtetin.

Teuta Rugova, duke potencuar se ministri i Jashtëm ka qenë kryetar i këtij Komisioni dhe është njohur me punën, vlerësoi se do të lehtësojë bashkëpunimin në mes të MPJ-së e Kuvendit. Shpreson që në të ardhmen të kemi takime të këtilla më të shpeshta dhe të njihemi më për së afërmi me punën që po e bën MPJ.

Pal Lekaj, përgëzoi ministrin për angazhimet në diplomaci, por theksoi se lidhur me këtë raportim është dashur që deputetët të kenë raport me shkrim. Shprehu shqetësimin sa i përket mënyrës së funksionimit të ambasadave tona, ndërsa sa i përket arrestimit të kryepolicit të Mitrovicës, tha se është për të ardhur keq që, MPJ, nuk ka reaguar me kohë. Duhet të veprojmë në kohë, të jemi të vendosur dhe seriozë në reciprocitet me atë që veprojnë serbët, tha z. Lekaj. Lidhur me demarkacionin e kufirit mes Kosovës dhe Malit të Zi, mendon se qarqet ndërkombëtare nuk e thonë se duhet të jetë ky apo ai version, porse duhet të bëhet marrëveshja, edhe pse shumë shtete nuk e kanë të zgjidhur çështjen e demarkacionit dhe janë pjesë e BE-së. Pyeti ministrin: A është njohur Kosova nga 111 apo 109 shtete? Sa i përket punësimit në ambasada, mendon se duhet bërë ndryshime, duke vlerësuar përvojat e tyre, sjelljet e tyre dhe se a janë të denjë për ta përfaqësuar shtetin. Pyeti ministrin: A ka ndonjë kod etik për ambasadorët? Lidhur me vulat apostile, kërkoi sqarim nga ministri se, pse ende nuk u njihen qytetarëve tanë nga disa vende, edhe pse tani më është ratifikuar marrëveshja për vulat apostile.

Qerim Bajrami, duke u ndërlidhur me arrestimin e z. Thaçit, tha se ministri e ka mbështetjen për marrjen e masave të reciprocitetit me Serbinë ndaj të gjithë zyrtarëve të saj, të cilët shpesh vijnë në Kosovë, të ftuar e të pa ftuar. Gjithashtu, ai deklaroi se ministri e ka përkrahjen në hapat që i ka marrë rreth zgjidhjes së çështjes së lirisë së udhëtimit të qytetarëve të Kosovës dhe qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës në Kosovë. Z. Qerimi bëri të ditur se Shqipëria e ka zvogëluar nivelin diplomatik me Bosnjën, tani nuk ka as ambasadë që një kohë e ka pasur, e cila i ka kryer punët e qytetarëve të Kosovës dhe të Bosnjës, që jetojnë në Bosnjë e Hercegovinë, prandaj është mirë që të aktivizohet sërish vënia e marrëdhënieve në mes të këtyre dy vendeve. Lidhur me përmbushjen e obligimeve për liberalizimin e vizave, kërkoi që të përcaktohen saktë obligimet primare dhe sekondare që duhet të përmbushen.

Luljeta Veselaj- Gutaj, përgëzoi ministrin për punën dhe intensitetin e punës që ka pasur gjatë kësaj periudhe kohore. Përkrahu reagimin e z. Lekaj për mungesën e raportit me shkrim nga ministri, për të cilin tha se mund të dërgohet, edhe më vonë. Pyeti ministrin, lidhur me marrëveshjet e arritura me Italinë, për transportin ndërkombëtar rrugor, se deri ku ka arritur nga pala italiane ratifikimi i kësaj marrëveshjeje dhe për marrëveshjen për njohjen reciproke të patentë shoferëve, për të cilën tha se Italia ende nuk i njeh patentë shoferët e Kosovës, përderisa shtetasve të tjerë u njihet patenta e vendit nga i cili vijnë.

Blerta Deliu-Kodra, tha se Serbia është duke bërë fushatë të rëndë represive në gjithë mekanizmat e saj. Kuvendi ynë është i përfaqësuar në Asamblenë Parlamentare të Evropës Juglindore dhe aty është një luftë e hapur e shteteve mike të Serbisë, që ta pengojnë Kosovën, përkundër faktit që jemi anëtar, me të drejta të plota. Serbia është munduar që të pengojë udhëheqjen e një komisioni në këtë asamble, nga pala kosovare, çështje për të cilën duhet ta këtë një fokus. Njoftoi se Komisioni për Punë të Jashtme është pjesë e Task-forcës për anëtarësimin e Kosovës në mekanizma kulturorë dhe është duke bërë një punë të madhe, që të anëtarësohemi në organizata të nivelit më të ulët se UNESCO. Ajo pyeti ministrin për mundësinë e riaplikimit të Kosovës në UNESCO, ndërsa sfidë tjetër theksoi edhe prezantimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, nën akronimin e Rezolutës 1244 dhe pyeti ministrin se, si e shfaq këtë problematikë. Gjithashtu, pyeti ministrin: A do të ketë hapje të reja të përfaqësive diplomatike në Azi e Afrikë?

Po ashtu, kërkoi një opinion nga ministri, lidhur me temën nga përfaqësues të opozitës se, në pesë vitet e ardhshme, do të ketë luftë në Ballkan.

Donika Kadaj-Bujupi, theksoi se sipas informatave është tejkaluar kuota e emërimit partiak të ambasadorëve dhe lidhur me këtë, kërkoi të informohet nga ministri, se pse po vazhdohet me emërime partiake të ambasadorëve. Lidhur me arrestimi e z. Nehat Thaçit, tha se ka pasur fare pak reagime dhe se angazhimet për lirimin e tij, janë të pamjaftueshme. Duke pasur parasysh në deklaratën e Komisionit se do të ndërpriten bisedimet me Serbinë, në rast të përsëritjes së këtij veprimi, pyeti ministrin se a ka një qëndrim serioz që ky dialog të ndërpritet, derisa nuk kemi reciprocitet apo këto janë vetëm shanse të reja për Serbinë, që të vazhdojë me arrestime, ndërsa ne të vazhdojmë të kërcënojmë se në rastet e reja, do t'i qasemi seriozisht problemit. Si kritere të fundit, të pa përmbushura për liberalizimin e vizave, tha se janë lufta kundër korrupsionit dhe marrëveshja për demarkacion, i cili version aktual nuk i ka votat, prandaj duhet të tregohemi më serioz dhe të gjejmë një zgjidhje për të dalë nga kjo krizë. Shqetësim shumë i madh për

bashkësinë ndërkombëtare lidhur me liberalizimin e vizave, para kriterit të demarkacionit, tha se është gjendja e rëndë ekonomike, varfëria e papunësia, të cilat po e nxisin migrimin. Migrimi përmendet në të gjitha takimet, si një rrezik eventual në të ardhmen, për shkak të mungesës së perspektivës në vend që është përgjegjësi eksplicite e Qeverisë, që të punojë dhe t'i kthejë shpresat tek njerëzit se mund të jetojnë në Kosovë. Kërkoj të njoftohet nga ministri lidhur me kompanitë për të lobuar për liberalizim të vizave, Paton Boggs LLP, të cilat tha se asnjëherë nuk kanë dhënë ndonjë raport. Cilat kanë qenë aktivitetet e tyre për lobim?

Po ashtu, znj. Kadaj-Bujupi, pyeti ministrin edhe për kontratën e nënshkruar me Cambrige Academy of Global Affairs: A është shpallur tenderi, a janë respektuar procedurat tenderuese dhe a është bërë publikimi për tender në KRPP, cilat janë konsulentët që po punojnë në këtë projekt dhe çka ka ndodhur me këtë kontratë? Ajo, po ashtu, pyeti ministrin se sa marrëveshje janë zbatuar nga marrëveshjet që dy qeveritë, ajo e Shqipërisë dhe e Kosovës, që i kanë arritur në mbledhjet e përbashkëta dhe se çfarë është ndërmarrë në MPJ, lidhur me shkresën e 32 zyrtarëve për parregullsitë në këtë ministri?

Albulena Haxhiu, theksoi se pavarësisht vendimit të institucioneve të Kosovës për ndalim të hyrjes së Gjuriqit në Kosovë, ai ka deklaruar se, nuk do ta respektojë këtë vendim dhe se do të hyjë në territorin e Kosovës. Pyeti: A do të jenë në gjendje institucionet e Kosovës, që të arrestojnë Gjuriqin, nëse tenton të hyjë në territorin e Republikës së Kosovës?

- A janë verifikuar njohjet nga Uganda dhe Nigeria, ngase ky problem daton qysh nga mandati i kaluar? Lidhur me njohjen nga Vatikani, pyeti ministrin se çka është bërë lidhur me këtë njohje, pasi që në vitin 2014, ka deklaruar se është afër njohja nga Vatikani.

Znj. Haxhiu tha se ministri ka deklaruar në vitin 2014 se njohjet nga 2-3 vende anëtare të BE-së janë shumë afër, ndërsa ato ende nuk kanë ndodhur, pyeti se në çfarë stadi ka arritur procesi me autoritete greke, sllovaqe, rumune, por edhe me ato të Spanjës, si dhe çfarë plani ka MPJ e MPB, për aplikimin për në Europol, në sa organizata ndërkombëtare është anëtarësuar Kosova, a është kryer studimi për anëtarësim në OKB, cili ka qenë roli i MPJ-së kundër zgjedhjes së Vuk Jeremiqit, si sekretar i përgjithshëm i OKB-së dhe çfarë ka ndërmarrë MPJ, lidhur me çështjen e UNESCO-s? Njëkohësisht, pyeti: A është studiuar fakti se pse Japonia ka votuar kundër anëtarësimit të Kosovës në UNESCO dhe a është analizuar ky dështim?

Enver Hoxhaj, fillimisht bëri të ditur se do të emërohet një zyrtar ndërlidhës në MPJ, për bashkëpunim më të ngushtë në mes të ministrisë dhe komisioneve parlamentare e deputetëve. Duke u ndërlidhur me çështjet e ngritura nga deputetët, tha se Kosova është e anëtarësuar në disa organizata ndërkombëtare, por jo në ato parlamentare, prandaj do të duhej një fokus më i madh në të ardhmen, në këtë drejtim. Po ashtu, z. Hoxhaj tha se në MPJ nuk është punuar mjaft, mirëpo mund të punojmë më shumë dhe më mirë dhe se asnjëherë nuk ka menduar se në vitin 2016 do të jemi jashtë OKB-së dhe pa njohje të plotë evropiane. Për situatën në MPJ, për shkresën e 32 punëtorëve, ministri Hoxhaj tha se stafi i tij e ka mbështetjen e plotë, ndërsa ekziston një përshtypje e stafit diplomatik, se asnjëri nga ata, nuk dëshirojnë të kthehen në Kosovë dhe të shërbejnë në ministri. Një pjesë e madhe e nënshkruesve të kësaj shkrese, kanë qenë në misione të caktuara dhe është dashur të kthehen në MPJ, në bazë të rotacionit. Është rregull, në çdo vend, që një diplomat të shërbejë dy mandate jashtë dhe një mandat brenda vendit. Si ministër, tha se është me rëndësi të ketë një shërbim të mirë edhe jashtë, edhe brenda Kosovës. Ministri ceku se gjatë punës së tij, mund të ketë bërë ndonjëherë ndonjë gabim, por se nuk e sheh stafin e tij, atë ku ushtron interesa të caktuara. Sa i përket përplasjes fizike që ka

ndodhur në mes sekretarit të përgjithshëm dhe një punëtori, tha se nuk ka qenë një ngjarje e mirë në ministri dhe se për këtë çështje ka biseduar edhe me kryeministrin. Sekretari i përgjithshëm emërohet nga Qeveria e Kosovës, gjegjësisht Bordi i Emërimeve të Larta, dhe se nuk e di se çfarë vendimi do të merret për këtë rast. Tek përfaqësimi ynë jashtë dhe tek vizitat brenda vendit tonë, tha se kemi shumë tensione dhe keqkuptime, por reagojnë në baza ditore dhe se ka bërë një shkresë për çdo ministri, për çdo zyrtar, sesi duhet të përfaqësohet në takime ndërkombëtare.

Sa i përket funksionalizimit të ambasadave të Kosovës, ministri njoftoi se synojnë që ta kenë një shërbim të jashtëm, i cili ka shtrirje globale, me misionet e vogla, me përshkrim të punëve për secilin prej tyre. Ka insistuar që në misione të ketë atashe të forcave të sigurisë, të ekonomisë e të kulturës, t'i definojnë punët e tyre dhe për këtë janë të detyruar të marrin zyrtarë nga ministrinë tjera përkatëse. Ministri bëri të ditur se raportin me shkrim, lidhur me këtë raportim, do t'ia sjellë Komisionit. Ai njoftoi se kanë reaguar me kohë, sa i përket arrestimit të z. Thaçit dhe se në komunikimin diplomatik veprimet duhet të jenë më të mëdha karshi gjuhës së jashtme. Sa u përket njohjeve, ministri theksoi se tani janë 112 vende që e kanë njohur Kosovën dhe se janë të kujdesshëm që të mos i shpallin njohjet, para se ato të ndodhin dhe se do të ketë edhe tri njohje të reja. Sa i takon Ugandës dhe Nigerisë, jemi në komunikim me këto vende, për sqarim të plotë për atë që ka ndodhur lidhur me njohjet nga këto dy vende.

Ambasadat e Kosovës, konsideron se kanë diplomatë të denjë për kohën në të cilën jetojnë dhe çdo prezantim dinjitoz i tyre, ndihmon shtetin e Kosovës, ndërsa kodi i sjelljes së diplomatëve është më shumë brendapërbrenda vetë diplomatëve. Për vulat apostile, tha se janë në kontakt me Gjermaninë, Suedinë dhe Austrinë, që edhe këto shtete ta pranojnë këtë marrëveshje dhe të tejkalohet kjo sfidë. Gjithashtu, njoftoi se është në bisedime e sipër për shfuqizimin e regjimit të vizave me Bosnjë dhe Hercegovinën, në mënyrë që të arrihet marrëveshja në mes të dy vendeve dhe të lëshohen në kufi. Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi, tha se është kusht për liberalizimin e vizave, nëse qytetarët e Kosovës dëshirojnë të udhëtojnë pa viza në Evropë. Sa i përket marrëveshjeve të arritura me Italinë, njoftoi se ka bërë përpjekje që ato të ratifikohen, por kjo procedurë varet prej vetë dinamikës që kanë institucionet italiane. Ministri njoftoi se Serbia është duke bërë një fushatë në disa nivele kundër Kosovës, por ne nuk duhet të bimë në grackë të saj dhe duhet të sillemi sipas një koncepti më afatgjatë. Përkrah vendimin e Komisionit për Punë të Jashtme që të jetë pjesë e Task-forcës duke kërkuar që anëtarët e këtij Komisioni të jenë pjesë edhe e grupeve tjera punuese, që janë në themelimin e sipër. Në pyetjen e parashtruar se a mund të ketë luftë të re në Ballkan, ministri Hoxhaj tha se diplomacia është instrument i paqes. Lidhur me kuotën e ambasadorëve, bëri të ditur se do të bëjë një kalkulim të kuotës së ambasadorëve politikë dhe atyre të karrierës. Sa i përket hapjes së ambasadave të reja, tha se jemi të interesuar të hapim një ambasadë në Afrikë, një në Azinë Juglindore dhe në Amerikën Latine.

Lidhur me pyetjen për Paton Boggs LLP për Kosovën, tha se është i gatshëm ta sjellë një raport të plotë lidhur me këtë organizatë, për kontratën, shumat dhe punët që ka kryer deri më tani, ndërsa për Cambrige Academy of Global Affairs, informoi se kanë qenë të detyruar që për raste të caktuara të angazhojnë ekspertë ndërkombëtarë për proces të caktuar, konkret. Ministri njoftoi se për riaplikim në UNESCO, kanë bërë disa ekspertiza, për të bërë një studim më të hollësishëm. Sa u përket marrëveshjeve me Shqipërinë, njoftoi se në disa fusha ka pasur progres, ndërsa në disa të tjera nuk ka pasur dhe se në mbledhjen e radhës do të bëjë përpjekje që të kemi një partneritet dhe shkëmbim më të madh në mes të dy vendeve. Bëri të ditur se me Vatikanin ka disa komunikime dhe se parimisht bëhen përpjekje që me çdo vend të krijohen shumësi kontaktesh, që në një periudhë prej 2-3 viteve, një vend ta njohë Kosovën. Situatë të njëjtë, tha se

kemi pasur edhe me Greqinë, por njohja e Kosovës nga një vend tjetër kërkon edhe krijimin e situatës së favorshme.

Nëse në vitin e ardhshëm e zbatojmë agjendën e reformave me 17 prioritete dhe 40 indikatorë, do ta përdorim platformën evropiane edhe në raport me Greqinë, Sllovakinë dhe Rumaninë. Njoftoi se me Europol-in janë në fazë të bashkëpunimit, sikurse edhe vendet e tjera të rajonit, ndërsa për anëtarësimin e Kosovës në OKB, është hartuar një strategji. Ministri Hoxhaj njoftoi edhe për angazhimet e MPJ-së, që Vuk Jeremiqi, të mos zgjidhet sekretar i OKB-së. Shkaqet e mos votimit të Kosovës nga Japonia për anëtarësim të Kosovës në UNESCO, janë çështjet të cilat ajo i ka pasur me Kinën, brendapërbrenda UNESCO-s.

Donika Kadaj- Bujupi, kërkoi nga ministri që krahas raportit për kuotën e ambasadorëve dhe raportit për Paton Boggs LLP, të bashkëngjitet edhe raporti për Cambridge Academy of Global Affairs.

Enver Hoxhaj, duke u përgjigjur në pyetjen e deputetes, z. Kadaj Bujupi, se a do të ndërpritet dialogu për shkak të arrestimit të z. Thaçi, ministri u përgjigj se kjo pyetje është përtej mandatit të tij, por do të bëjë përpjekje, derisa z. Thaçi të lirohet.

Elmi Reçica, falënderoi ministrin Hoxhaj për raportim, si dhe e njoftoi atë se Komisioni është i përkushtuar që ta rrisë intensitetin e angazhimit, dhe se do të përpiqet t'i realizojë objektivat dhe detyrat e tij.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Elmi Reçica